

*Janë Pleure*  
*[Signature]*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr. \_\_\_ prot.

Tiranë, me \_\_\_/\_\_\_/2024

Lënda: Nisëm për propozimin e projektligjit "Për disa shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

**KRYETARES SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Sh.S. Znj. Lindita Nikolla

Tiranë

E nderuar znj. Kryetare,

Mbështetur në nenet 81 pika 1 dhe pika 2 shkronja "d", 83 të Kushtetutes si dhe nenin 68 të Rregullores së Kuvendit, paraqesim për shqyrtim dhe miratim në Kuvend projektligjin "Për disa shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Bashkëlidhur gjeni tekstin e projektligjit dhe relacionin shoqërues.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

**Deputetët propozues**

**Etilda Gjonaj**

**Erion Braçe**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_\_\_\_ 2024

PËR

**DISA SHITESA NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995 "KODI PENAL I  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 pika 1 dhe pika 2 shkronja "d" dhe 83 pika 1 të Kushtetutes, me propozimin e deputetëve, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar bëhen këto shtesa:

**Neni 1**

Pas nenit 288/b shtohet neni 288/c me këtë përmbajtje:

**Neni 288/c**

1. Shitja, furnizimi për qëllime tregtimi, ofrimi falas, shitja me ofertë e produkteve të duhanit, cigareve elektronike dhe çdo produkt tjetër të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, personave nën moshën 18 vjeç kur më parë ndaj personit janë marrë masa administrative, përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 100.000 deri në 300.000 lekë ose me burgim deri në 6 muaj.
2. Shitja, furnizimi për qëllime tregtimi, ofrimi falas, shitja me ofertë e produkteve të duhanit, cigareve elektronike dhe çdo produkt tjetër në ambiente të destinuara të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, kur më parë ndaj personit janë marrë masa administrative përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 300.000 deri në 500.000 lekë ose me burgim nga 6 muaj deri në 1 vit.
3. Kur si pasojë e kryerjes së veprës penale të parashikuar në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni, ka ardhur si pasojë dëmtimi i rëndë i shëndetit të të miturit, dënimi është nga 4 deri në 8 vjet burgim.
4. Kur si pasojë e kryerjes së veprës penale të parashikuar në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni, ka ardhur si pasojë vdekja e të miturit, dënimi është nga 8 deri në 16 vjet burgim.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**LINDITA NIKOLLA**



**RELACION  
PËR  
PROJEKTLIGJIN DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995 "KODI  
PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektligji me shtesat e propozuara ka për qëllim kategorizimin vepër penale të shitjes, ofrimit falas, shitjes me ofertë për të miturit nën moshën 18-vjeç të duhanit dhe produkteve të duhanit, në rast ripërsëritje.

**II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Përdorimi i duhanit nga të rinjtë mbetet një shqetësim i lartë për shëndetin publik. Vitet e fundit ka pasur një rritje alarmante të përdorimit të duhanit dhe produkteve të duhanit tek fëmijët dhe të rinjtë. Konsumimi i nikotinës tek fëmijët dhe adoleshentët ka ndikime negative në zhvillimin e tyre. Ajo sjell pasoja negative afatgjata për zhvillimin e trurit dhe mund të shkaktojë çrregullime në të mësuarin dhe gjithashtu shkakton ankth. Po ashtu edhe ekspozimi i drejtpërdrejtë apo aksidental i fëmijëve ndaj lëngjeve që cigaret elektronike përmbajnë, paraqet rrezik serioz për ta, pasi pajisjet mund të rrjedhin dhe fëmijët mund të gëlltisnin lëngun, i cili është helmues<sup>1</sup>.

Më 20 dhjetor 2019, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës u miratua ndryshimi i Aktit Federal të Ushqimit, Barnave dhe Kozmetikës, i cili rrit moshën minimale federale për shitjen e produkteve të duhanit nga 18 në 21 vjeç. Me anë të këtij legjislacioni (i njohur si "Duhani 21" ose "T21") është e paligjshme që një shitës me pakicë të shesë çdo produkt duhani, duke përfshirë cigare, puro dhe e-cigare, të rinjve nën moshën 21 vjeç<sup>2</sup>.

Ligji federal vendos dënime administrative dhe penale për shitësit me pakicë ose bizneset e tjera që u shesin produkte të duhanit të miturve. Si i tillë, çdo shitës me pakicë ose pronar biznesi që shkel ligjin federal do t'i nënshtrohet burgut, gjobave ose revokimit të licencës së tyre të biznesit për të shitur produkte të duhanit<sup>3</sup>.

Në Gjermani shitja e duhanit nën moshën minimale dënohet me gjobë deri në pesë milionë euro. Shkeljet e kufizimeve në shitjen e makinave shitëse automatike dënohet me gjobë deri në 50,000 euro. Shkeljet e kufizimeve për shitjen e duhanit pa tym dënohen me burgim deri në një vit ose me gjobë<sup>4</sup>.

Në rastin e Irlandës gjithashtu Akti (Ligji) i Shëndetit Publik<sup>5</sup>, nr. 35, ndryshuar në fund të vitit 2023 parashikon masa administrative dhe penale për shkeljet. Sipas këtij ligji shitja e cigareve elektronike tek të miturit nën moshën 18-vjeç përfshin dënimin me gjobë deri në 4,000 € (3,461 £) dhe deri në gjashtë muaj burg.

---

<sup>1</sup> Analizë krahasuese, Nr. 22/2024, "Rregullimi ligjor i Bashkimit Europian dhe disa shteteve anëtare të tij për cigaret elektronike", Instituti Parlamentar, Kuvendi Republikës së Shqipërisë.

<sup>2</sup> [Tobacco 21 | FDA](#)

<sup>3</sup> [What Is the Penalty for Selling Tobacco to a Minor? | LegalMatch](#)

<sup>4</sup> [Germany Penalties | Tobacco Control Laws](#)

<sup>5</sup> <https://www.irishstatutebook.ie/eli/2023/act/35/enacted/en/index.html>



Gjithashtu, në kushtet kur masat administrative të parashikuara në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", të ndryshuar", nuk kanë dhënë efektet e synuara për reduktimin e përdorimit të duhanit nga të rinjtë, konsiderohet e nevojshme krahas ndryshimeve të propozuara tashmë për ligjin e sipërpërmendur, edhe ndërhyrja në kodin penal, për rritjen e masave parandaluese dhe rekuperuese.

Bazuar në sa më sipër është ndërmarrë nisma ligjore për ndërhyrje në ligjin nr. 7895/1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

### **III. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Bazuar në sa më sipër propozohen ndryshimet dhe shtesat në ligjin nr. 7895/1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, sikurse më poshtë:

#### **Neni 1**

Pas nenit 288/b shtohet neni 288/c me këtë përmbajtje:

#### **Neni 288/c**

- 1. Shitja, furnizimi për qëllime tregtimi, ofrimi falas, shitja me ofertë e produkteve të duhanit, cigareve elektronike dhe çdo produkt tjetër të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, personave nën moshën 18 vjeç kur më parë ndaj personit janë marrë masa administrative, përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 100.000 deri në 300.000 lekë ose me burgim deri në 6 muaj.*
- 2. Shitja, furnizimi për qëllime tregtimi, ofrimi falas, shitja me ofertë e produkteve të duhanit, cigareve elektronike dhe çdo produkt tjetër në ambiente të destinuara të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, kur më parë ndaj personit janë marrë masa administrative përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 300.000 deri në 500.000 lekë ose me burgim nga 6 muaj deri në 1 vit.*
- 3. Kur si pasojë e kryerjes së veprës penale të parashikuar në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni, ka ardhur si pasojë dëmtimi i rëndë i shëndetit të të miturit, dënimi është nga 4 deri në 8 vjet burgim.*
- 4. Kur si pasojë e kryerjes së veprës penale të parashikuar në paragrafin e parë dhe të dytë të këtij neni, ka ardhur si pasojë vdekja e të miturit, dënimi është nga 8 deri në 16 vjet burgim.*

Këto dispozita parashikojnë që në rastet e ripërsëritjes së kundërvajtjeve administrative të parashikua në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", të ndryshuar", të konsiderohen vepër penale në rastin fundor.

### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është hartuar në përputhje me nenin 81 pika 1 dhe pika 2 shkronja “d” dhe nenin 83 pika 1 të Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare dhe legjislacionit në fuqi.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BASHKIMIT EVROPIAN**

Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” nuk synon përafrimin e *Acquis* të Bashkimit European.

#### **VII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektligji nuk parashikon efekte financiare në buxhetin e shtetit.